



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Rr. Xhorxh Bush, nr. 31, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383-38-222970 • E-mail: filologjia@uni-pr.edu • www.filologjia.uni-pr.edu

Komisioni për shqyrtimin e ankesave

Nr. Prot.: 03/2357 Datë: 15.7.2026

Mbështetur në Vendimin me nr. prot. 01/2263, datë 8/7/2026 të Këshillit të Fakultetit të Filologjisë dhe në zbatim të Konkursit me nr. 1/999, dt. 29/6/2026 të Senatit të UP-së, Komisioni për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve të pakënaqur me rezultatin preliminar të provimit pranues për pranimin e studentëve të rinj në studimet themelore - baçelor, në vitin akademik 2026/27, mori

V E N D I M

I. **REFUZOHEN** si të pabazuara ankesat e parashtruara nga kandidatët e papranuar në vitin e parë të studimeve në studimet themelore - baçelor për vitin akademik 2026/27, sipas rezultatit preliminar.

Nr. i ankesës dhe dt. e ankesës	Nr. i dosjes së aplikimit	Programi i studimeve	Trajtimi i ankesës
04/2324 dt. 13.7.2026	100276	Gjuhë dhe letërsi angleze	E pabazuar
04/2321 dt. 13.7.2026	100257	Gjuhë dhe letërsi angleze	E pabazuar
04/2320 dt. 13.7.2026	100237	Gjuhë dhe letërsi angleze	E pabazuar
04/2319 dt. 13.7.2026	100151	Gjuhë dhe letërsi angleze	E pabazuar
04/2318 dt. 13.7.2026	100146	Gjuhë dhe letërsi angleze	E pabazuar
04/2332 dt. 13.7.2026	100099	Gjuhë dhe letërsi angleze	E pabazuar
04/2330 dt. 13.7.2026	100378	Gjuhë dhe letërsi angleze	E pabazuar
04/2346 dt. 14.7.2026	100290	Gjuhë dhe letërsi angleze	E pabazuar
04/2342 dt. 14.7.2026	100138	Gjuhë dhe letërsi angleze	E pabazuar
04/100165 dt. 14.7.2026	100165	Gjuhë dhe letërsi angleze	E pabazuar

II. **VËRTETOHEN** rezultatet preliminare të provimit pranues për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore – baçelor për vitin akademik 2026/27 i publikuar me datë 9/7/2026.

Arsyetim

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur me datë 15.7.2026, i shqyrtoi ankesat e kandidatëve të pakënaqur me rezultatin preliminar të provimit pranues për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore – baçelor për vitin akademik 2026/27.

Komisioni i ankesave në përbërje të plotë ka shqyrtuar ankesat e kandidatëve duke ju referuar dispozitave të Konkursit me Nr.Prot. 1/999, dt. 29/6/2026. Lidhur me pretendimet për mënyrën e llogaritjes së pikëve të testit të maturës, komisioni i ankesave thekson se të njëjtat janë të pabazuara në pikën II – Mënyra e përzgjedhjes së kandidatëve, neni 1, pika b e Konkursit nr. 1/999, dt. 29/6/2026, përcaktohet se vlerësimi i kandidatëve bëhet mbi bazën e një sistemi me gjithsej 100 pikë, ku testi i maturës vlerësohet me maksimum 30 pikë dhe këto pikë gjenerohen automatikisht nga sistemi elektronik i aplikimit, i cili bën konvertimin e rezultateve si për kandidatët e gjeneratave me sistem vlerësimi prej 100 pikësh, ashtu edhe për ata me sistem prej 200 pikësh, duke zbatuar të njëjtën metodologji të përcaktuar në konkurs, rrjedhimisht komisionet vlerësuese nuk kanë kompetencë të ndërhyjnë në llogaritjen e këtyre pikëve dhe konfirmimi i aplikimeve bëhet nga shërbimi i studentëve bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatët, prandaj pretendimet lidhur me pikëzimin e testit të maturës mes kandidatëve të pranuar dhe papranua nuk janë të bazuara.

Krahas kësaj komisioni i ankesave, pas pranimit të ankesave të parashtruara, i është drejtuar komisionit vlerësues me kërkesë për shqyrtimin e pretendimeve të ankuesve lidhur me vlerësimin dhe pikët e kandidatëve në testin pranues. Pas rishqyrtimit të pretendimeve nga komisionet vlerësuese dhe konfirmimit të rezultateve të vlerësimit, komisioni i Ankesave ka marrë vendimin përkatës.

Duke marrë parasysh këtë çfarë u tha më lart, si dhe raportet e komisioneve në nivel departamentesh pas konsultimit me kandidatë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni i Ankesave:

1. Prof.asst. Faton Ismajli – kryetar
2. Prof.asst. Ardita Berisha – anëtare
3. Asst. Ilir Breca – anëtar

